

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE MINISTRY OF INFRASTRUCTURE	
Nr./Eshia Org. Org. Jerënia Org. Unit	KM-MIT
Nr./Faqeve Bc. Stranica No. Pages	2
Nr./Prot. Proj. Prot. Prot. No.	213/19
Data: Datum: Date:	19.04.19
PRISHTINE/A	



REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE MINISTRY OF INFRASTRUCTURE	
Nr./Eshia Org. Org. Jerënia Org. Unit	01
Nr./Faqeve Bc. Stranica No. Pages	01
Nr./Prot. Proj. Prot. Prot. No.	6153
Data: Datum: Date:	19.04.19
PRISHTINE/A	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**  
 Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit  
 Ministarstvo Infrastrukture i Transporta  
 Ministry of Infrastructure and Transport

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit , në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) , të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe nenin 38 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Rregulloren Nr.26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2016 dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

### VENDIM

**I. Refuzohet** kërkesa nr.2151 e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus NTP "Vaidi" me seli në Ferizaj për marrjen e nisjeve në relacionin: Viti-Kllokot- Pozhoran- Prishtinë (neper autostraden Arben Xhaferi) dhe anasjelltas me orare të nisjes (06:30 - 09:35, 10:00 - 15:10, 13:00 - 16:35, 14:00- 18:10).

### Arsyetim

Pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht Ligjin nr.04/L-179 për Transportin Rrugor në mbështetje të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër-urban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016, është konstatuar që operatori transportues rrugor të udhëtarëve me autobus NTP "Vaidi" me seli në Ferizaj nuk ka plotësuar kushtet ligjore për ndarjen e

nisjeve të lira në relacionin e lartëcekur të përcaktuara sipas nenit 8 të U.A nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin nderurban të udhëtarëve me autobus si dhe kushtet e shpalljes publike për marrjen e nisjeve në relacionin: Viti- Klllokot- Pozhoran- Prishtinë (neper autostraden Arben Xhaferi)dhe anasjelltas me orare të nisjes (06:30 - 09:35, 10:00 - 15:10, 13:00 - 16:35, 14:00- 18:10), pasi që operatori nuk ka prezantuar në dosjen respektive deshmite për rendet e udhëtimit nuk i ka hartuar sipas shpalljes publike perkatesisht rendet e prezantuara permbajne relacion tjetër.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

### Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrojë ankesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.



### I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Operatorit Transportues;
- Arhivit.